

REZOLUTË

MBI PROGRESIN E SHQIPËRISË NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN PËRGJATË VITIT 2018

Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, dhe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

- Nxitur nga vullneti dhe mbështetja e plotë e qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin e merituar të Shqipërisë në Bashkimin European;

- Me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave të ndërmarra për konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e institucioneve dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke marrë në konsideratë rekomandimin e pakushtëzuar të Komisionit European për hapjen e negociatave të anëtarësimit, bazuar mbi përparimin e arritur nga Shqipëria në përmbushje të çështjeve parësore të përcaktuara nga Komisioni European;

- Duke marrë në konsideratë përfundimet e Këshillit European të qershorit 2018, në të cilat Këshilli ra dakord që t’i përgjigjej pozitivisht përparimit të Shqipërisë dhe përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019;

- Duke marrë në konsideratë vijimin dhe thellimin e mëtejshëm të përparimit të vendit në procesin e integrimit në Bashkimin European, reflektuar në zbatimin efektiv të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit European për hapjen e negociatave të anëtarësimit;

- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të përmbushjes së kriterit politik të Kopenhagenit, si reforma në drejtësi dhe reforma të tjera në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- Duke marrë në konsideratë rëndësinë e funksionimit të duhur të Kuvendit mbi bazën e dialogut konstruktiv politik për përparimin e Shqipërisë në procesin e integrimit european;

- Duke rikonfirmuar se hapja e negociatave dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin European është qëllimi strategjik kombëtar i Shqipërisë, si një vend që synon konsolidimin e demokracisë, respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të bashkëpunimit reciprok, të transparencës, të gjithëpërfshirjes dhe të ekonomisë funksionale të tregut, të cilat përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi European;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Rikonfirmon se anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European është objektiv i madhor i vendit dhe kryeson agjendën e tij kombëtare.

2. Konfirmon qasjen e tij se përparimi në procesin e integrimit european të Shqipërisë bazohet në hartimin dhe zbatimin e reformave transformuese dhe të pakthyeshme.

3. Vlerëson mbështetjen që Bashkimi European dhe vendet anëtare kanë dhënë për Shqipërinë, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës, forcimit të institucioneve dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

4. Thekson se dialogu konstruktiv ndërpartiak brenda institucioneve kushtetuese është thelbësor për procesin e integrimit në BE.

5. Thekson rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integrues të vendit.

6. Vlerëson progresin e arritur përgjatë vitit 2018 në përmbushjen e detyrimeve, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe plotësimin e rekomandimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit.

7. I kërkon Qeverisë të konsolidojë reformat e arritura dhe të vijojë të thellojë më tej reformat për plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.

8. I kërkon Qeverisë Shqiptare të ruajë dhe të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të marrë pjesë në nismat rajonale, si dhe të zbatojë angazhimet në kuadër të Procesit të Berlinit.

9. Angazhohet që të forcojë dhe të përmirësojë më tej aktivitetin e organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integritit evropian, si Komisioni i Integritit Evropian dhe Këshilli Kombëtar për Integritimin Evropian, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integritit evropian.

10. Angazhohet të garantojë dhe të fuqizojë integritetin dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

11. Angazhohet të vazhdojë të shqyrtojë me përparësi dhe në një proces të gjerë konsultimi kuadrin ligjor që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës reformuese të integritit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën e vendit, konventat ndërkombëtare dhe *acquis*-in e Bashkimit Evropian.

12. Mbi bazën e arritjeve në plotësimin e përparësive kyçe, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kërkon Këshillit Evropian që të miratojë hapjen zyrtare të bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë në këtë fazë të rëndësishme të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe vazhdimit të mëtejshëm të reformave në vend.

Miraturar më datë 11.4.2019

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**